

DËSHMORËT E GREIKOCIT

Revistë e SHFMU «Dëshmorët e Greikocit» - Greikoc

Nr. 12- Prill 2017 - Greikoc

Urime 5 Prilli - Dita e shkollës!



NXËNËS TË DALLUAR TË SHKOLLËS SONË

DITURIA ËSHTË FLORI



Një ndër nxënëset, që është shembull në shkollën tonë, është Enkela Qelaj, nxënëse e klasës IV/2 te mësuesja Sevdie Lushaj. Është një vajzë modeste, e shoqërueshme, por mbi të gjitha shumë e zgjuar, e cila me kënaqësinë më të madhe i mëson lëndët mësimore, duke u shprehur gjithmonë me thënien: “Dituria është flori”.

Çdo person ka ëndrra të veçanta në jetë dhe merr një profil të caktuar. Edhe Enkela ka një ëndërr për të ardhmen, meqenëse profesioni i mjekësisë është diçka humane, ajo dëshiron që t'u dalë në ndihmë njerëzve, duke u bërë një mjekë shembullore. Enkelës i urojmë shumë suksese në të ardhmen!

Sami Baraliu

MË PËLQEN LEXIMI



Ledion Kurtishaj është sinonim i nxënësit të shkëlqyeshëm. Mësimet i ndjek në klasën III/1 te mësuesja, Elhame Zenelaj. Atij i pëlqejnë të gjitha lëndët mësimore, por me theks të veçantë pëlqen matematikën dhe gjuhën shqipe. Pasioni i tij është leximi. Ka dëshirë edhe të recitoj. Bile, në shumë programe shkollore, që organizohen për nder të festave të ndryshme, Ledioni merr pjesë suksesshëm.

Për Ledionin flet me admirim edhe mësuesja e tij, Elhame Zenelej, e cila thotë se Ledioni është shembull se si duhet të jetë një nxënës shembullor.

Kur e pyetëm Ledionin se çfarë ka dëshirë të bëhet në të ardhmen, ai pa asnjë hezitim na tha se dëshiron të bëhet polic. Profesioni i policit e tërheq shumë, ngase ka dëshirë që të kontribuojë në stabilitetin e vendit tonë.

U ndamë nga Ledioni, duke i uruar shumë suksese në ardhmen!

Sevdie Lushaj

DUA TË BËHEM INXHINIER I NDËRTIMTARISË

Quhem Lendion Curraj. Jam nxënës i klasës së tretë (III/2). Mësuesja ime quhet Razë Spahiu. I jam shumë falënderues mësueses sime, ngase na mëson dhe edukon. Punon me përkushtim.

Lendioni është nxënës shembullor në çdo aspekt. I pëlqen matematika, por pasion e ka leximin. Edhe pse ende i ri me moshë, ai ka lexuar disa lektura shkollore. Gjithashtu, i pëlqen recitimi. Kur mësojnë ndonjë poezi, Lendioni është ndër të parët që e reciton poezinë në mënyrë artistike.

Kur e pyetëm se çka dëshiron të bëhet në ardhmen, ai na u përgjigj se detyrën e inxhinierit e pëlqen shumë. I pëlqejnë projektet. Për Lendionin të gjithë kanë fjalë të mira. Edhe shokët e shoqet e klasës flasin me admirim për të. Edhe mësuesja Razë thotë se po të ishin të gjithë si Lendioni gjërat do të ishin ndryshe. - Andaj, Lendionit i uroj shumë suksese e të na bëhet një inxhinier i mrekullueshëm, thotë mes tjerash, mësuesja Razë. Shumë suksese për inxhinierin e ardhshëm!

Nasuf Krasniqi



MË PËLQEN UNIFORMA E BARDHË

Quhet Ledion Zenelaj. Është nxënës i klasës V/2 te mësuesja Pranvera Selimi. Është nxënës shembullor në çdo aspekt, si në mësim, ashtu edhe në sjellje. Shembullin e Ledionit duhet ta ndjekin edhe nxënësit e tjerë të shkollës sonë. Ka lexuar vepra të shumta. I pëlqejnë të gjitha lëndët mësimore, e në veçanti matematika e gjuha shqipe.

-Edhe unë si çdo fëmijë tjetër kam dëshirat e mia, por për t'u plotësuar këto dëshira duhet punë dhe vullnet, - shprehet Ledioni dhe vazhdon: “Që i vogël kisha dëshirë të mësoja dhe të bëhem një mjek i dalluar. Shpresoj se me punë e përkushtim do ta realizoj këtë ëndërr timen”, - thotë Ledioni.

Për angazhimet e Ledionit tregon dhe mësuesja e tij, Pranvera Selimi.

Në fund, Ledionit i urojmë sukses dhe që një ditë ta veshë uniformën e bardhë dhe t'u dalë në ndihmë të gjithë atyre që kanë nevojë.

Suksese për Ledionin!

Merita Kukaj



DUA TË BËHEM ARSIMITAR I MATEMATIKËS

Quhem Erlis Kurtishaj. Jam nxënës i klasës IV/1 te mësuesja Besa Beqiraj. Jam nxënës shembullor në të gjitha lëndët, si dhe në aktivitetet e lira.

Jam i pasionuar pas lëndës së matematikës. Për aktivitetin e këtij nxënësi tregon mësuesja, Besa Beqiraj. Aktiviteti i këtij nxënësi është i gjithanshëm. Në çdo program artistik shkollor merr pjesë si recitues.

Erlisi merret edhe me shkrime. Poezitë e tij zënë vend në revistën e shkollës sonë, por edhe në gazetën e murit.

Si profesion ka dëshirë ta zgjedhë matematikën. Dua të bëhem profesor i matematikës dhe njerëzit që kam për këtë lëndë t'i shpreh të tjerët. I uruam shumë sukses Erlisit dhe të na bëhet një profesionist i vërtetë i lëndës së matematikës, lëndë që ka mungesë kuadrosh.

Raza Spahiu




GJUHA SHQIPE – LËNDË QË E PREFEROJ

Melisa Kurtishaj është nxënëse e klasës II/2. Mësuesja e saj është Qëndresa Thaçi – Qelaj. Të gjitha lëndët mësimore i pëlqejnë. Por, Melisës më së shumti i pëlqen gjuha shqipe. Edhe pse ende e vogël, me përkushtim të madh i është dhënë gjuhës shqipe. Ka dëshirë të lexoj shumë, por edhe gramatika e gjuhës e tërheq mjaft. Është kënaqësi të shohësh se sa bukur lexon, duke i respektuar edhe shenjat e interpunkcionit.

Në të ardhmen ka dëshirë të bëhet mësuese. Profesioni i mësuesit më pëlqen shumë. E shoh mësuesen time se sa bukur na mëson, prandaj edhe unë dëshiroj të që të ndjek rrugën që ndoqi mësuesja ime. Më pëlqen shumë që të jap mësim, andaj do të mësoj e punoj shumë, në mënyrë që të arrij atë që dëshiroj. Suksese të mëtejme për Melisën!

Lumturie Kuçi





LEXUES TË NDERUAR,

Si zakonisht është bërë traditë tanimë për t'i zgjedhur dy-tri fjalë për lexuesin me rastin e nxjerrjes së përvjetshme të revistës "Dëshmorët e Greikocit" të shkollës sonë. Në këtë numër të revistës janë mbarshtruar tema dhe përmbajtje të larmishme të fushës edukativo-arsimore.

Njeriu asnjëherë nuk kënaqet me arritjet e tij. Është kjo një moto që do të shërbejë për të gjithë, edhe për ne, që mënyrë të vazhdueshme të synojmë për nivele të avancuara të arsimimit të gjeneratave të reja, duke qenë nesër konkurrues të dijës me shtetet më të zhvilluara evropiane. Kjo asnjëherë nuk mund të arrihet në mënyrë individuale, por me punën e bashkërenduar të të gjitha institucioneve arsimore të Republikës së Kosovës.

Kontribut të çmuar në nxjerrjen e këtij numri dha drejtori i ri i shkollës sonë, z. Naser Kurtishaj, të cilin e falënderojmë dhe i urojmë shumë suksese në detyrën e re. Një falënderim i veçantë shkon edhe për sponsorin tonë gjeneral, Shoqatën "Greikoci", që vazhdimisht na gjendet afër, duke na ndihmuar për nxjerrjen e revistës sonë.

Jemi në prag të 5 prillit – Ditës së shkollës dhe përvjetorit të dëshmorëve. Dëshmorët gjithmonë do t'i kujtojmë me pietet e krenari. Mburremi me veprën e tyre madhore. Lavdi u qoftë!

Në fund, e ndjejmë për detyrë që t'i falënderojmë të gjithë ata, që me shkrimet e tyre e pasuruan këtë numër të revistës sonë, si nxënësit, ashtu edhe arsimtarët.

Kolegë të nderuar, urime 5 prilli - Dita e shkollës!

Fikret RAMAJ

DËSHMORËT E GREIKOCIT
Revistë e shkollës fillore dhe të mesme të ulët
"Dëshmorët e Greikocit"

BOTUES:

Këshilli i shkollës

REDAKTOR PËRGJEGJËS:

Fikret RAMAJ

KOLEGJIMI I REDAKSISË:

Tahir ZENELAJ

Merita KUKAJ

Besa BEQIRAJ

Ilaz KICAJ, nxënës

BASHKËPUNËTORËT:

Sami BARALIU

Besim HALITAJ

Hashim KUKAJ

Nasuf KRASNIQI

Ardhmërie BARALIU

Elhame ZENELAJ

Fahri KUKAJ

Argjir QELAJ, nxënës

Ermira SELIMAJ, nxënëse

Aulon HAXHAJ, nxënës

Freskim BEQIRAJ, nxënës

KORREKTORË:

Zelie LUSHAJ

SEKRETARE E REDAKSISË:

Raza SPAHIU

Realizimi kompjuterik në redaksinë
e revistës **"FIDANI"**

Dorëshkrimet dhe fotot nuk kthehen.

FALËNDERIM

Drejtorja e shkollës, Këshilli i shkollës, si dhe redaksia e revistës falënderon nga zemra sponsorin gjeneral, Shoqatën "Greikoci", që na ndihmoi për nxjerrjen e këtij numri.

NJË ARSIMTAR BASHKËKOHOR DUHET TË JETË NXËNËS GJATË GJITHË JETËS

Drejtori Naser Kurtishaj u lind më 1979 në Greikoc. Ka mbaruar fakultetin e gjuhës dhe letërsisë angleze në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Gjithashtu, ka regjistruar studimet master në degën e gjuhës angleze. Ka titullin profesor. Në arsim ka përvijë tetëvjeçare. Ai me kënaqësi pranoi që t'i përgjigjet pyetjeve tona.



Naser Kurtishaj

D. E GREIKOCIT: Z. drejtor na jepni një letërnjoftim të shkurtër?

N. KURTISHAJ: Quhem Naser Kurtishaj, i lindur dhe i rritur në fshatin Greikoc, në një familje mesatare, ku primare ka pasur nderin dhe edukatën, e përshtatur me rrethanat dhe traditat e aso kohe, pasi që fshati jonë njihet për shumë familje bujare. Si fëmija më i vogël i familjes, shkollën fillore e përfundova në fshat, ndërsa gjimnazin e shkencave të natyrës në Suharekë. Studimet për gjuhë dhe letërsi angleze i përfundova me sukses në Prizrenin e bukur, për të vazhduar më vonë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, ku edhe arrita të marr titullin profesor i gjuhës dhe i letërsisë angleze. Në arsim kam tetë vjet përvijë pune, kryesisht, në Gjimnazin “Jeta Re” në Suharekë.

D. E GREIKOCIT: Jeni zgjedhur në postin e drejtorit. Cilat janë prioritetet tuaja në fillim të mandatit?

N. KURTISHAJ: Prioriteti kryesor do të jetë ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe të të nxënës, krijimi i një klime të mirë në shkollë. Vitin e ardhshëm pritet që të fillojmë të punojmë me

kurrikulë të re, e cila ndryshon bukur shumë nga kjo e tanishmja, andaj me doemos arsimtarët duhet të ndjekin trajnimet, në mënyrë që mos të hasin vështirësi në aplikimin e saj. Sa i përket infrastrukturës, në fokus do të jetë rregullimi i oborrit me të gjitha standardet, që kërkon një shkollë e mirëfilltë. Rregullimi i oborrit të shkollës, për të cilat investime komuna jonë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, na ka ofruar mbështetjeje me një fond prej 28,000 €, për të cilat jo vetëm ne si shkollë, por i tërë komuniteti i është mirënjohës.

D. E GREIKOCIT: Keni qenë nxënës i shkollës, ku tani jeni drejtor. Na thoni çfarë ndjenje është kjo?

N. KURTISHAJ: Është me të vërtetë ajo ndjenje që të jep energji për t'i shtyer proceset përpara në realizimin e reformave moderne dhe në krijimin e kushteve ideale për nxënësit, sepse është vetë fëmijëria ime, që më flet për barrierat dhe vështirësitë e edukimit të asaj kohe. Por, nuk mund të anashkaloj edhe privilegjin, që më sjellin ish- arsimtarët e mi, duke më ofruar mbështetje në çdo aspekt.

D. E GREIKOCIT: Z. drejtor keni qenë profesor në Gjimnazin e Suharekës. Tani jeni drejtor shkollë. Na thoni si u pritët nga kolektivi i shkollës kur dikur keni qenë i saj dhe si e përjetuat ndarjen nga kolegët e Gjimnazit?

N. KURTISHAJ: Nëna Terezë thoshte: “Pritja më e mirë është buzëqeshja” në fakt ishte mikpritje shumë e ngrohtë dhe aspak djallëzore për të cilën ia vlen që ta ruaj në ditarin e nostalgjive të bukura. Ndërkaq, vetë fjala *ndarje* nuk tingëllon mirë, por unë kisha një vizion të qartë për t'i kontribuar komunitetit tim dhe kjo më dha kurajon për të ndërmarrë një vendim të tillë.

D. E GREIKOCIT: Si do ta koordinoni punën tuaj mes arsimtarëve, prindërve dhe fshatit në tërësi?

N. KURTISHAJ: Të punosh me njerëz të nivelit apo rangut të njëjtë në të cilën je edhe vetë dhe të gjithë i përkasim profilit arsimor, atëherë është shumë lehtë për të bashkëpunuar, sepse kemi gjuhë të përbshkët dhe gjejmë mirëkuptim të

ndërsjellë. Do të mundohemi që raportet në mes të prindërve dhe të arsimtarëve të relaksohen sa më shumë. Prindërit më bashkëpunues janë ata që kanë fëmijët më të dalluar dhe të edukuar, sepse janë vetë lajmet e mira dhe lëvdatat, që ua shtojnë vullnetin për t'u interesuar për ecurinë e tyre. Ne, në veçanti kemi nevojë që të na ofrojnë bashkëpunim ata prindër, të cilët fëmijët e tyre nuk janë të suksesshëm, kanë vështirësi në nxënie dhe u mungon edukata, me qëllim që t'ju ndihmojmë në ato vështirësi që kanë. Nëse me lejohet kjo çështje nuk qëndron vetëm në shkollën tone, por është shqetësuese edhe në nivel shteti.

D. E GREIKOCIT: Çfarë mendoni a duhet të ndryshojë mësuesi i sotëm në raport me nxënësin?

N. KURTISHAJ: Unë mendoj se kohë më parë mësuesit e kanë filluar këtë ndryshim, tani veç janë duke vazhduar drejt përsosmërisë së kësaj reforme.]

D. E GREIKOCIT: Puna që është bërë në të kaluarën dhe kjo që bëhet sot a kanë ndryshim. Kam parasysh se në atë kohë nuk keni punuar në arsim, por keni qenë nxënës. Na e tërhiqni një paralele?

N. KURTISHAJ: Nuk mund t'ia lejoj vetes ta bëj një krahasim në mes të këtyre dy periudhave kohore, sepse në atë kohë nuk i kam njohur rregulloret e arsimit dhe kam mundur të paragjykoj pa të drejtë, por dallimin më të madh pozitiv e vërej se ka ndryshuar mentaliteti i prindërve ndaj shkollës. Ata sot kanë një qasje më të madhe ndaj shkollës dhe arsimimit të fëmijëve. Në atë kohë prindërit vinin në shkollë vetëm kur ftoheshin nga arsimtarët kujdestar, madje ishin vetëm meshkuj, ndërkaq sot nuk ka ditë që nuk vizitohet shkolla nga prindërit, pa dallim gjinie dhe konsideroj se është një hap mjaft pozitiv në avancimin dhe emancipimin e shoqërisë sonë.

D. E GREIKOCIT: A ndikon në cilësinë e mësimiit avancimi i teknologjisë informative?

N. KURTISHAJ: Duke pasur parasysh që është pikërisht teknologjia ajo që po bënë hapat më gjigant në kohën moderne, duke e lehtësuar jetën dhe punën e njerëzimit. Po bënë diversitetin kulturor global, me fjalë të tjera e ka bërë botën më të vogël në aspektin funksional. Pra, është bërë pjesë e jetës së çdo shtresë, duke mos njohur as moshë e kjo ka ndikuar që edhe fëmijët të ndryshojnë mënyrën e argëtimit dhe lojës së tyre, pra nga loja fizike në atë teknologjike. Prandaj, nëse e përdorim teknologjinë në mësimdhënie kjo nënkupton se ne kemi arritur që të hyjmë në botën e tyre dhe kështu nxënësi do ta pranojë mësimin më shumë si lojë se sa obligim. Prandaj, unë mendoj se teknologjia në arsim duhet të aplikohet sa më shumë me gjithë vështirësitë që ka, për ta zënë këtë hap.

D. E GREIKOCIT: Seminaret, trajnimet e ndryshme a janë bazë e mirë për një përgatitje sa më të mirë të mësuesit të sotëm?

N. KURTISHAJ: Një arsimtar bashkëkohor duhet të jetë nxënës gjatë gjithë jetës. Hulumentimet më të fundit kanë nxjerrë një konkludim shumë interesant, ku thuhet se: Njohuritë që kemi sot, pas një dekade do të na hyjnë në punë vetëm 10%. Kjo për arsye se rrisitë në jetë janë shumë dinamike dhe në këtë mënyrë njohuritë tona ngelin shumë modeste, në qoftë se nuk begatohemi me dituri të reja. Një instrument shumë efikas për të rifreskuar njohuritë tona metodologjike janë: trajnimet, seminarat dhe konferencat e ndryshme.

D. E GREIKOCIT: Shkolla jonë prej kohësh nxjerr edhe revistën e shkollës. Çfarë mendoni për punën që bënë redaksia e revistës?

N. KURTISHAJ: Botimi i një reviste, në radhë të parë i duhet një vullnet i madh, një dashamirës dhe njohës i gazetarisë, një angazhim të palodhshëm, pastaj kërkon një bashkëpunim të koordinuar mirë në të mes të kolegëve dhe të nxënësve dhe një periudhë kohore mjaft të gjatë, e mbi të gjitha një buxhet me kosto bukur të lartë. Mirëpo, shkolla jonë asnjëherë nuk e ka pasur të vështirë botimin e revistes, falë arsimtarit të shkëlqyer, Fikret Ramaj, i cili me shumë dashuri dhe pasion e kryen punën gazetareske, kurse edhe më të lehtë na e bënë përkrahja e Shoqatës "Greikoci", të cilën e kemi edhe sponsor gjeneral të revistës, për të cilën u jam shumë mirënjohës.

D. E GREIKOCIT: Jemi në prag të Ditës së shkollës, por edhe të përvjetorit të dëshmorëve të fshatit tonë. Cili është mesazhi Juaj për këtë ditë?

N. KURTISHAJ: Shkolla jonë është duke përgatitur një program të larmishëm artistik, ku nxënësit tanë do të kenë mundësitë, që të shpalosin punën dhe talentet e tyre, në fusha të ndryshme, në ditën më të veçantë për ta dhe njëkohësisht do të mundohemi që ditën e dëshmorëve ta shënojmë në mënyrë sa më dinjitoze. Familjarëve të dëshmorëve urimet më të sinqerta për Ditën e dëshmorëve. Lavdi e përjetshme dhe Ju qoftë i lehtë dheu i Kosovës së lire!

D. E GREIKOCIT: Z. drejtor, faleminderit për këtë intervistë.

N. KURTISHAJ: Kënaqësia ishte edhe imja, që të përgjigjesha në intervistën time të parë në cilësinë e drejtorit të shkollës. Ju faleminderit edhe redaksisë suaj!

*Intervistuan:
Fikret RAMAJ &
Sami BARALIU*

PËRVJETORI I NËNTËMBËDHJETË I DËSHMORËVE TË FSHATIT TONË

Në përvjetorin e nëntëmbëdhjetë përkujtojmë dëshmorët e fshatit tonë: Jakup Kurtishaj, Hazir Selimaj, Avdyl Beqiraj, Haxhi Haxhaj, Sabit Lushaj, Zenel Curraj, Naser Tafaj dhe Safet Kicaj.



Jakup Kurtishaj

GREIKOCI PYET PASHTRIKUN

Toka ime e bekuar
Nisi luftëtarët e lirisë
Në tokën e premtuar
Në rrugën e pavarësisë.



Hazir Selimaj



Avdyl Beqiraj

Greikoci krenar pyet Pashtrikun
Ç'u trondite atë natë
M'u vranë trimat e tu
Në këtë rrugë të gjatë.



Haxhi Haxhaj

Dhe n'Greikoc u përhap lajmi
Ranë dëshmorë bijtë e mi
Në çdo rrugë zotëron heshtja
Pikëllimi ra në çdo shtëpi.



Sabit Lushaj

Kush tha se ata kanë vdekur
Kush tha se ata s'janë gjallë
Trimat e tillë nuk vdesin kurrë
Kosova për ta sot ka mall.



Zenel Curraj

UÇK- ja është krenare
Për pishtarët e saj luftëtarë
Që shtrinë për tokë bishën barbare
Rroftë flamuri ynë kombëtar!



Naser Tafaj



Safet Kicaj

Fatmir KASTRATI, prof.

RRUGË E MUNDISHME DHE E GJAKOSUR PËR SHKOLLËN SHQIPE

Përplekja dhe lufta e vazhdueshme për gjuhën dhe shkollën shqipe, ishin pjesë përbërëse e luftës së popullit shqiptar për liri, për pavarësi, për bashkim kombëtar dhe për përparim shoqëror e civilizues. Shkolla shqipe dhe arsimtarët tanë bënë rrugë të mundimshme e të gjakosur. Të mundimshme, të gjakosura ishin të gjitha periudhat e zhvillimit të shkollës shqipe në përgjithësi, por në veçanti të shkollës shqipe në Kosovë në vitet 1989-1999.



Haki Haziraj


Kësaj radhe po shkruajmë për një arsimtar të devotshëm të periudhës më të vështirë të arsimit shqip. Mësues Hakiu që nga viti 1977 ka filluar të punojë në detyrën e shenjtit të mësuesit. Që nga ajo kohë ka edukuar dhe arsimuar shumë gjenerata. Mbresa të pashlyeshme i ka lënë viti 1990, kur punëtorët arsimorë në mënyrë kategorike refuzuan planet dhe programet asimiluese e diskriminuese të okupatorit serbosllavë. Gjatë kësaj periudhe kohore, mësues Hakiu në frontin e dijes, kulturës dhe edukimit u dallua për tiparet e njeriut korrekt, të komunikueshëm, të papajtuështëm me të metat e gabimet. Prandaj, cilido i detyronte respekt, për fjalën dhe veprën e tij të mirë. Mësues Hakiu nuk është i njohur vetëm brenda mureve të shkollës. Në veprimtarinë e tij shoqërore, shokët dhe bashkëfshatarët e gjejnë njeriun e ditur, gojëmbël, të matur dhe dashamirës. Jo rrallë, prindërit e nxënësve këshilloheshin, por ende këshillohen me të për probleme të ndryshme të mësimin, të sjelljes.

Fjala e mësues Hakiut edhe sot peshon. Puna e çmuar dhe e përkushtuar, mendja dhe dora e mësues Hakiut janë skalitur dhe mishëruar te dhjetëra e qindra nxënës të tij. Andaj, edhe

shumë mësues e kanë si model, mësues Hakiun, i cili vazhdimisht i këshillon dhe i sugjeron për punë të suksesshme.

Mësues Hakiu u lind më 1956 në një familje fshatarësh, me tradita të bujarisë, arsime dashëse dhe me ndjenja të atdhedashurisë.

Duke pasur parasysh punën e tij shumëvjeçare në procesin mësimor, gjatë kësaj kohe me shumë sakrificë dhe sfida ka dhënë kontribut para nxënësve. Është i afërt me ta. Të gjithë e respektojnë dhe flasin me admirim për punën



dhe kontributin e tij më se 40-vjeçar në arsim. Në vitin shkollor 2016/2017 nga kolektivi i shkollës sonë u zgjodh mësuesi më i mirë dhe për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit u nderuar me mirënjohje nga Drejtoria Komuna e Arsimit e Therandës.

Mësues Hakiu është një prind shembullor, model për t'u ndjekur.

Shumë suksese dhe shëndet të mirë për mësues Hakiun!

Fikret RAMAJ

Dëshmorët e Grekocit

PËR TA NDRYSHUAR AMBIENTIN PËR TË MIRË, KËRKOHEM PËRGJEGJËSI MAKSIMALE

Hyrje

Para se të fillojmë raportimin e dytë për veprimtarinë e shoqatës „Greikoci“ ,shprehim falënderimet më të sinqerta për të gjithë anëtarët e sa, të cilët po mundësojnë realizimin e të gjitha aksioneve të ndërmarra nga Shoqata jonë me kontributin e tyre financiar. Gjithashtu, falënderojmë, veçanërisht koordinatorin e shoqatës „Greikoci“, Ramadan Canaj, i cili po përfaqëson vlerat dhe idetë e Shoqatës me përpikëri në Greikoc, sipas modelit zviceran. Më tutje, falënderojmë Arianit dhe Albion Selimaj, të cilët po përkujdesen në kontinuitet për grafikën e flyerave dhe mirëmbajtjen e webfaqes së shoqatës „Greikoci“.

Me siguri do ta hetoni se shumica e aksioneve të vitit 2016 kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e ambientit. Ky fakt nuk është i rastësishëm. Mirëpo vlen të ceket se kryesia e shoqatës „Greikoci“ vendosi që brenda vitit 2016 aktivitetet e Shoqatës të fokusohen në fushën e mirëmbajtjes së ambientit, pasi që të gjithë jemi të njoftuar se ambientit në fshatin Greikoc nuk i kushtohet shumë rëndësi. Për ta ndryshuar ambientin për të mirë, kërkohet nga të gjithë banorët përgjegjësi maksimale, duke evituar hedhjen e materialeve jo organike në hapësirat shoqërore. Pasi që ky synim në vendin tonë nuk realizohet me përpikëri, Shoqata „Greikoci“ me aksionet e saj, në fushën e mirëmbajtjes, ka si prioritet senzibilizimin e banorëve të fshatit Greikocit rreth përgjegjësisë që kanë si banor për mirëmbajtjen e vendit tyre.

Në fund, ju njoftojmë se në mbledhjen e kaluar të anëtarësisë, më 17 prill 2016, anëtarët prezent vendosën për ndryshimet statutare, ku u fuqizua roli i kryesisë i Shoqatës „Greikoci“. Tash e tutje kryesia e Shoqatës është e ngarkuar me përzgjedhjen dhe implementimin e projekteve në fusha të ndryshme , si dhe raportimin e tyre një herë në vit para anëtarësisë dhe Këshillit Kontrollues të Shoqatës.

Pastrimi i ambientit (mars 2016)

Më 21.3.2016 me rastin e ditës së pranverës, në fshatin Greikoc u bë pastrimi i ambientit.

Iniciativa për pastrimin e fshatit Greikoc u mundësua dhe u financua nga shoqata “Greikoci”. Menaxhues i projektit ishte njëri nga anëtarët e kryesisë së shoqatës “Greikoci”, z.Rexhep Neziraj, i cili kishte udhëtuar enkas për këtë aksion në vendlindje dhe kishte në mbështetje koordinatorin për Kosovë, z.Ramadan Canaj.

Kësaj iniciative i dolën në ndihmë banorët e fshatit, si dhe nxënësit e shkollës fillore “Dëshmorët e Greikocit” të udhëhequr nga drejtorja dhe arsimtarët e shkollës.

Pastrimi i fshatit filloi në mëngjes, duke përfshirë rrugët e shkollës dhe më pas vazhdoi në tërë fshatin, ku u grumbulluan më shumë se dy kamionë me mbeturina të llojeve të ndryshme. Shoqata „Greikoci“ financoi, brenda këtij aksioni, materialin për pastrim, si: thasë, doreza, derivate për mjetet transportuese, si dhe drekën për të gjithë pjesëmarrësit në këtë aksion.



Përkrahje për botimin e revistës „Dëshmorët e Greikocit“, nr.11 (prill 2016)

Kryesia e Shoqatës „Greikoci“ vendosi që pas kërkesës së arsimtarit , Fikret Ramaj, ta mbështetë botimin e revistës „Dëshmorët e Greikocit“, nr. 11, në aspektin material.

Kjo revistë botohet çdo vit, në prill, për nder të dëshmorëve të fshatit të rënë në luftën e fundit në Kosovë në vitin 1998 dhe 1999. Botues u revistës është Këshilli i shkollës. Revista përmban punime të ndryshme, si: poezi, vizatime, rrëfime apo intervista të nxënësve dhe të mësuesve të shkollës fillore të fshatit Greikoc. Njëkohësisht ju njoftojmë se kryesia e shoqatës „Greikoci“ ka vendosur që të jetë sponsor gjeneral i kësaj reviste edhe për vitet e ardhshme.



Shoqata „Greikoci“ - raport vjetor 2016



Iftar për bashkëvendasit (korrik 2016)

Me 3 korrik 2016, ditë e diel, shoqata „Greikoci“ i ftoi banorët e fshatit Greikoc për një iftar, gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit. Ky iftar u mbajt në oborrin e Xhamisë së Fshatit dhe kishte mbi 100 pjesëmarrës. Shoqata „Greikoci“ mbështet çdo aktivitet, ku ndodh grumbullimi i bashkëvendasve me synime për të ndryshuar shoqërinë për së miri.

Kompjuterët për shkollën e Greikocit (korrik - gusht 2016)

Gjatë muajit korrik, shoqata „Greikoci“ vendosi që t'i dhurojë katër kompjuterë për shkollën fillore të fshatit Greikoc. Motivi ishte që, nxënësit e shkollës të kenë kushte sa më të mira për zhvillimin arsimin informatik. Shoqata „Greikoci“ konstatoi se njohuritë në fushën e informatikës janë të domosdoshme dhe mbështet edukimin e shoqërisë në këtë fushë. Njëkohësisht shprehim falënderimet për kompaninë „Gani Transport“ nga Dietikon, kantoni i Cyrihut – Zvicër.



Punësohen dy persona për mirëmbajtjen e ambientit (gusht 2016)

Me 9 gusht 2016, shoqata „Greikoci“ zyrtarizoi punësimin e dy personave nga kjo organizatë për mirëmbajtjen e ambientit të fshatit:



Beqir Canaj dhe Rexhep Lushaj. Këta punëtorë do të jenë përgjegjës për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, hapjen e varrezave, largimin e mbeturinave, pastrimin e përrenjve etj.

Kjo Shoqatë, po ashtu, ka dorëzuar një traktor të vogël (golldan), si dhe rrobat e punës për këta punëtorë. Shoqata „Greikoci“ kërkon nga të gjithë banorët e fshatit Greikoc mirësjellje dhe përkrahje në mirëmbajtjen e ambientit.

Synimet për vitin 2017

Për vitin 2017, kryesia e Shoqatës ka vendosur që fokus kryesor të ketë mirëmbajtjen e ambientit të fshatit Greikoc. Gjithashtu, do të përkrahë në vazhdimësi projekte, ku mbështetën të rinjtë e fshatit Greikoc. Projektet konkrete do të pasojnë gjatë pranverës së vitit 2017.

Rreth shoqatës „Greikoci“:

Themelimi:	17 maj 2015
Selia:	Ossingen AG – Zvicër
Numri i anëtarëve:	mbi 165
Kryetar:	Rexhep Neziraj (+41 79 489 49 92)
Webfaqja:	www.greikoci.ch
Kontakt:	shoqata_greikoci@gmx.ch
Facebook:	Shoqata Greikoci

Sedat SELIMAJ

SA MË SHUMË QË TË SHKOLLOHEMI E ARDHMJA ËSHTË MË E SIGURTË

Mësues Bajrami u lind më 1958 në fshatin Greikoc. Ka mbaruar SHLP – degën e historisë e gjeografisë në Gjakovë. Ka titullin arsimtar. Në procesin edukativo – arsimor ka filluar të punojë që nga viti 1982. Pa hezitim pranoi që t'i përgjigjet pyetjeve të redaksisë.



Bajram Neziraj

D. E GREIKOCIT: *Kush është mësues Bajrami?*

B. NEZIRAJ: Kam lindur më 1958 në fshatin Greikoc. Rrjedh nga një familje me tradita atdhetdashurie. Jam i martuar dhe kam dy djem. Gjithmonë jam përpjekur që të kontribuoj për fshatin tim. Kam edukuar dhe arsimuar shumë, prandaj gjeneratën e re e këshilloj dhe e sugjeroj që sa më shumë të shkollohen, në mënyrë që ardhmëria jonë të jetë e sigurtë.

D. E GREIKOCIT: *Kur keni filluar të punoni për herë të parë në detyrën e shenjtë të mësuesit?*

B. NEZIRAJ: Pas mbarimit të shkollimit të mesëm, vendosa që të regjistrohem në drejtimin e shkencave shoqërore, ngase gjithmonë e kisha synim dhe pasion. U regjistrova në SHLP-në e Gjakovës në degën e Histori-Gjeografisë. Pasi që gjithmonë e desha këtë drejtim, me një afat të shpejtë edhe e mbarova. Pra, më 1983 diplomova dhe mora titullin arsimtar. Më pas, pata fatin të punësohem në fshatin tim. Që nga viti 1983 jam arsimtar i shkollës së fshatit. Detyra e mësuesit është e shenjtë, prandaj edhe sikur 100 jetë t'i kisha çdo herë kisha zgjedhur profesionin e mësuesit.

D. E GREIKOCIT: *Gjatë këtyre viteve të punës sate në arsim, a mund të na veçoni ndonjë moment që më së shumti iu ka ngelur në kujtesë?*

B. NEZIRAJ: Arsimi shqip është përballur me shumë sfida dhe vështirësish gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të tij. Prandaj, edhe gjeneratës sime iu desh që të përballet me këto vështirësi. Njëra ndër ngjarjet që më së shumti më ka ngelur në kujtesë ishte viti 1990, kur arsimi shqip u mëvetësua nga ai serb. Të gjithë arsimtarët refuzuan që të punonin me planet dhe programet serbe. Pas kësaj kohe, mësimi shqip pati vështirësi të shumta, po ideali që kishim për arsimimin dhe edukimin e brezave të rinj ishin mbi të gjitha. Një ndihmesë të madhe për shkollën shqipe dhanë edhe bashkëfshatarët tanë, të cilët na ndihmuan në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Gjatë kësaj periudhe shumë arsimtarë u vranë, por edhe shumë tjerë u maltretuan nga regjimi serb, por asnjëherë nuk u ndalën nga rruga që kishin nisur. E përballuam edhe këtë sfidë.

D. E GREIKOCIT: *Ju lutemi na e bëni një krahasim në mes të mësimit të atëhershëm dhe këtij të sotshmit?*

B. NEZIRAJ: Të bësh një krahasim në mes të mësim të atëhershëm dhe këtij në ditët e sotme duhet të analizohen shumë faktorë. Por, sa i përket shkollimit të atëhershëm besoj se duhet të çmohet, ngase mësimi tradicional i kohës solli gjenerata të shumta të të diplomuarve, të cilët ishin udhërrëfyes i gjeneratave të sotme. Në atë kohë mësuesi kishte autoritet. Fjala e tij kishte peshë të madhe. Shumë mësues të asaj kohe ishin ata që e nisën rrugën e pavarësimit të Kosovës, për ta kurorëzuar së fundmi kjo gjeneratë e sotme. Ndërkaq, mësimi i sotshëm zhvillohet në kushte më moderne. Nxënësit përveç mësuesit kanë edhe të tjera burime të informacionit. Pra, nxënësi i sotëm i takon kohës së teknologjisë informative. Prandaj, kur i kemi parasysh këto avancime edhe mësimi duhet të jetë më cilësor, si dhe rezultatet të jenë evidente.

D. E GREIKOCIT: *Keni fat të punoni me arsimtarë, që dikur i keni pasur nxënës. Diçka më tepër rreth kësaj?*

B. NEZIRAJ: Po, është e vërtetë. Kjo është një kënaqësi e madhe, ngase shoh se puna jonë është kurorëzuar me sukses. Shumë kolegë që punoj sot me ta, dikur ishin nxënës të mi. Nuk ka ndjenjë më të mirë se kjo. Shoh se ata kanë avancuar me shkollim. Kanë kryer trajnime e seminare të ndryshme. Kanë sukses në punën me nxënës, prandaj nuk më mbetet gjë tjetër, veçse t'ju uroj shumë suksese në punën e tyre të ardhme.

D. E GREIKOCIT: *Mësues Bajrami, pas shpërthimit të luftës në Kosovë, Ju keni qëndruar këtu dhe iu keni bashkëngjitur radhëve të UÇK-së. Pastaj nga Komisioni për verifikimin e veteranëve të luftës Ju jeni pajisur me certifikatën e veteranit të luftës. Çfarë ndjenje është kjo?*

B. NEZIRAJ: Koha e luftës ishte një kohë, që vërtet sot kur e kujtoj më rrëqeth. Ishin momente të vështira për popullin shqiptar. Prandaj, si shumë arsimtarë në mbarë Kosovën, edhe unë pata fatin të jem në radhët e UÇK-së së lavdishme. Shumë kolegë m'u vranë, duke u bërë dëshmorë të këtij vendi. Pas mbarimit të luftës, Qeveria e Kosovës, për ta nderuar këtë luftë ushtarët e UÇK-së i pajisi me certifikatën e veteranit. Në mesin e atyre që u pajisen me këtë certificate jam edhe unë. Vërtet është një ndjenjë e mirë, kur kujton se shteti yt të nderon dhe të respekton.

D. E GREIKOCIT: *A mendoni se mësuesi i sotëm është lënë në harresë?*

B. NEZIRAJ: Nuk besoj se mësuesi i sotëm është lënë në harresë. Është respektuar atëherë, po respektohet edhe sot. Natyrisht, kohërat kanë ndryshuar, por mësuesi dhe respekti ndaj tij do të

ngelin përgjithmonë.

D. E GREIKOCIT: *A i përkrahni reformat në arsim. A mendoni se këto reforma po sjellin cilësinë e kërkuar?*

B. NEZIRAJ: Natyrisht se jam për reforma. Cilësia në arsim duhet të ngritet. Mësuesi i sotëm punon në kushte më të mira, se përpara. Reformat janë të mirëseardhura, ngase sjellin mësimdhënie bashkëkohore. Jam për atë që sa më shumë të ketë trajnime dhe seminare, sepse ngritet cilësia e mësimit.

D. E GREIKOCIT: *Kjo bisedë zhvillohet për revistën e shkollës sonë. Çka mendoni për punën e redaksisë së revistës?*

B. NEZIRAJ: Redaksia po bën një punë të shkëlqyeshme. I përgëzoj për këtë angazhim. Në revistë pasqyrohet puna e nxënësve tanë. Shoh se revista lexohet me vëmendje nga i gjithë fshati. Prandaj, suksese redaksisë dhe puna e revistës të mos ndalet asnjëherë.

D. E GREIKOCIT: *Jemi në prag të Ditës së shkollës dhe përvjetorit të dëshmorëve. Cili është mesazhi Juaj?*

B. NEZIRAJ: Gjithë kolegëve të mi urime Dita e shkollës, njëkohësisht përkujtojmë edhe dëshmorët e fshatit tonë, të cilët dhanë jetën për këtë që ne po e gëzojmë sot. Dëshmorët gjithmonë do të kujtohen me pietet e krenari. Lavdi veprës së tyre madhore!

D. E GREIKOCIT: Faleminderit për bisedë.

B. NEZIRAJ: Me nder qofshi dhe faleminderit edhe nga Ju!

*Biseduan:
Fikret RAMAJ & Besim HALITAJ*

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT



Asambleja e Përgjithshme e njuh se dinjiteti njerëzor dhe të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore përbëjnë themelin e lirisë, të drejtësisë dhe të

paqes në botë. Të drejtat e njeriut mbrohen

me ligj. Marrëdhëniet miqësore midis kombeve duhet të forcohen. Popujt e Kombeve të Bashkuara kanë afirmuar besimin e tyre për të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe vlerën e individit, të drejtat e barabarta midis burrit dhe gruas. Gjithashtu, janë të vendosur ta çojnë më tej përparimin shoqëror, standarde më të mira të jetës dhe liri më të madhe. Kanë premtuar që të zhvillojnë më tej të drejtat e njeriut dhe një kuptim të përbashkët të këtyre të drejtave.

*Përgatiti:
Erëza CURRAJ, kl. IX/2*

PËRKUJTIM

U PREFTË NË PAQE SHPIRTI I KËTIJ MËSUESI TË NDRITUR!



Kaluan disa muaj kur nga ne u nda, kolegu e ish-drejtori i shkollës sonë, Zenel Beqiraj.

Neli, siç e quanim të gjithë ishte një intelektual i kompletuar. Vdekja e tij ishte një humbje e pakompensueshme, pasi që puna dhe këshillat e tij

ende na duheshin. Ishte i dalluar në punë, i urtë e tolerant.

Neli u lind më 1953 në Greikoc të Therandës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Therandë. Studimet universitare i vazhdoi në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin filozofik, ku mbaroi degën e pedagogjisë dhe mori titullin profesor i pedagogjisë.

Një kohë punoi si mësimsdhënës i disa lëndëve mësimore. Më vonë punësohet pedagog në shkollën

tonë. Puna e tij si pedagog la mbresa të një njohësi të shkëlqyer të kësaj fushe. Këshillat dhe sugjerimet që na i jepte ishin të mirëseardhura për ne.

Pas mbarimit të luftës, pra në vitin 2000, u zgjodh drejtor i shkollës, mandat, të cilin e mbajti deri në fund të jetës së tij.

Puna e palodhshme dhe virtytet pozitive të Nelit do të mbeten gjatë në kujtesën e atyre, që patën fatin të punojnë bashkë me të. Ka njerëz, siç ishte Neli, të cilët jetojnë pak, por që puna dhe vepra e tij lënë gjurmë të përjetshme në memorien shoqërore. Jeta e njeriut është ngushtë e lidhur me qëllimin e ardhjes së tij në këtë botë, pra të tregojë: dashurinë, respektin, tolerancën dhe kudjesin.

Dituria e tij, që ishte pishtar për shumë breza në këtë jetë, do të jetë dritë e parajsës në botën e përjetshme

Vdekja e hershme e kolegut tonë na preku thellë zemrat tona. Me këtë rast Ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta për Nelin, kolegun e shokun tonë të paharruar.

Prandaj, ne do ta kujtojmë, duke i ruajtur gjithmonë kujtimet më të mira për të.

Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës! U preftë në paqe shpirti i këtij mësuesi të ndritur!

Fikret RAMAJ

LAJME TË SHKURTRA

• Për nder të 28 Nëntorit – Ditë së Flamurit tonë kombëtar, nxënësit e shkollës sonë përgatitën një program të pasur kulturor e artistik. Gjithashtu, u punua edhe gazeta e murit, si dhe u vendos një ekspozitë me vizatime të ndryshme.

• Më 17 Shkurt 2017 për nder të nëntëvjetorit të pavarësisë së Kosovës, nxënësit e të dyja ndërrimeve përgatitën program kulturor-argëtues, në shenjë nderimi dhe respekti për këtë datë të shënuar.

• Për nder të 17 Shkurtit, nën përkujdesjen e arsimtares, Bukurie Asllanaj, u mbajtën garat në sport. Arsimtarja, kishte bërë përzgjedhjen e ekipeve të shkollës, duke bërë kombinimin e nxënësve. Njërin ekip e kishte formuar nga kombinimi i nxënësve të klasave të teta dhe nxënësve të klasave të shtata. Ndërsa, ekipi tjetër nga nxënësit e klasave të nënta dhe të gjashta. Fitues të garave futbollistike doli ekipi i klasave të teta dhe të shtata.

• Për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, arsimtarja, Zelie Lushaj, organizoi dhe mbajti një orë letrare. Nxënësit lexuan poezi të ndryshme, me motive nga Festa e Mësuesit.

• Mësuesi, Haki Haziraj, u zgjodh mësuesi më i mirë i shkollës sonë dhe për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit u nderua me mirënjohje nga Drejtoria e Komunale e Arsimit të Therandës.

• Me fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të këtij vitit shkollor

(2016 – 2017) filloi punën drejtori i ri shkollës sonë, z. Naser Kurtishaj. Drejtorit të ri i urojmë sukses!

• Kolegji “Mehtmet Akif” në Prizren organizon kurse pa pagesë për lëndët: matematikë dhe gjuhë angleze për nxënësit e klasave të pesta dhe të teta. Këto kurse nga shkolla jonë i ndjekin afërsisht 50 nxënës.

• Më 18 mars 2017 u mbajt Gara Ndërkombëtare e Matematikës Kangaroo 2017. Kjo garë u organizua dhe u mbajt në shkollën “Edit Durham” të Mushtishtit. Nxënësit do të futen në test në dy grupe: Nxënësit e grupit të parë do të jenë nxënësit e klasave: III, V, VII dhe IX, të cilët do ta kenë kohën e testimit nga ora 8, 45 minuta deri në orën 11,00. Nxënësit e grupit të dytë do të jenë nxënësit e klasave: II, IV, VI, VIII dhe XII, të cilët do ta kenë kohën e testimit nga ora 11, 15 minuta deri në orën 13,30. Vlen të potencohet se në këtë Garë nga shkolla jonë morën pjesë mbi 70 nxënës.

• Shkollën tonë në garat komunale të volejbollit do ta përfaqësojnë nxënësit: Aurora Beqiraj, Ermira Selimaj, Fllanza Beqiraj, Donika Beqiraj, Eriçona Haxhaj, Elona Kurtishaj, Denisa Beqiraj, Elionisa Lushaj. Nxënësit do të jenë në përkujdesjen e arsimtares, Bukurie Asllanaj.

• Në një mbledhje të mbajtur në shkollën tonë, drejtori i shkollës, z. Naser Kurtishaj, vendosi që nxënësve më të mirë që nga klasa e pestë deri në të nëntën t’ju ndajë lëvdata për suksesin e tyre.

Kronisti i shkollës

DISA VEÇORI THEMELORE TË FOLKLORIT MUZIKOR SHQIPTAR

Folklori shqiptar është shumë i pasur, mjaft i ruajtur edhe nuk është pertifikuar. Ai është shumë vital e kjo shihet edhe nga folklori bashkohor, i cili jeton, i përcjell ecuritë bashkëkohore shoqërore dhe ndryshimet në shoqëri. Këngët me të vjetra janë këngë rituale të periudhës dhe të karakterit pagan, këngët me prejardhje krishtere dhe këngët lirike familjare të lindejs dhe të martesës; këngët e dasmës, të vajtimeve etj. Pas tyre vijnë këngët me karakter epik (këngët kreshnike), këngët legjendare dhe baladat. Është shumë i pasur fondi i këngëve kreshnike historike, ku populli shqiptar i ka kënduar luftës së tij shekullore kundër pushtuesve të huaj dhe luftës për ekzistencë. Shumë këngë të këtilla mbështeten në ngjarje konkrete dhe ato janë burimore të vërteta për njohjen e ngjarjeve dhe të personaliteteve të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Këngët epike, mitologjike-legjendare, kreshnike e historike, kryesisht, i këndojnë meshkujt. Ndërsa, këngët lirike i këndojnë, kryesisht, femrat, por edhe fëmijët. Këngët këndohen me përcjellje instrumentale dhe pa to. Instrumentet që i përcjellin këngët

janë kryesisht: lahuta, çiftelia dhe sharkia e më pak fyelli e kavalli, si dhe defi te gjinia femërore. Në kohët më të reja, sidomos këngët qytetare përcillen edhe me violinë, klarinet, harmonikë e tarabuk etj. Këngët dhe vallet qytetare i përcillnin orkestrinat popullore, që dikur quheshin “çallgi”. Ndarjen themelore të folklorit muzikore shqiptar mund ta bëjmë në folklorin e gegëve dhe atë të toskëve -në përputhje me dy variantet e gjuhës së folur shqipe, përkatësisht dialektit gegë, që shtrihet në Shqipërinë Veriore. Elementi parësor i këngëve dhe i valleve popullore shqiptare është ritmi dhe masat (taktet). Masat (taktet) karakteristike që më së shumti i përdor muzika shqiptare janë: 2/4, 5/8, 7/8, 8/8, 9/8. Këto masa përdoren edhe në kombinime të ndryshme në mesin e tyre.

Edhe melodia e këngëve popullore është shumë e pasur dhe interesante. Për shkaqe të njohura ajo pjesërisht iu ekspozua ndikimeve të huaja, sidomos atyre me prejardhje orientale. Kjo dukuri vlen për këngët qytetare, në radhë të parë të qyteteve të Shqipërisë e me vonë dhe në Kosovë. Bazat tonale të këngëve dhe melodive shqiptare është moli natyral dhe moli harmonik e oriental. Mjaft i madh është numri i këngëve tona në moduset me tingëllim pentatonik e pak kanë bazën tonale dur. Ambitusi është i larmishëm nga intervali i tercës e deri te intervali i oktavës. Këngët tona këndohen me një zë dhe me shumë zëra. Folklori muzikor ka edhe një rëndësi të veçantë, sepse të gjithë kompozitorët shqiptarë (ku më pak e ku më shumë) i trajtuan këto tema popullore ose janë frymëzuar gjatë krijimtarisë së tyre.



Fitore Selimaj, kl. IX/1

Ardhmërie BARALIU,
prof. e edukatës muzikore

Dëshmorët e Grekocit

ANGAZHIM MAKSIMAL PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË

Nxënësit e klasave të nënta janë afër përfundimit të këtij viti shkollor. Redaksia e revistës sonë vendosi që të zhvillojë një anketë me ta. Ata pa hezitim pranuan që t'i përgjigjen pyetjes së Redaksisë: "Cila do të jetë preferenca juaj për të ardhmen?"

MIMOZA TAFAJ:



Rrugën e dijes e fillova në shkollën e fshatit tim. U rrita si një filiz, duke u pajisur vazhdimisht me dije nga arsimtarët tanë. Normalisht si çdo nxënës, ashtu edhe unë në kohën e duhur do të marr vendimin për të ardhmen time. Klasën e nëntë e vlerësoj si fillimin e themeleve të shkollimit tim, ku dija shtjellohet me

një fjalë – Infinit, pafundësi!

Pas mbarimit të klasës së nëntë unë mendoj të regjistrohem në gjimnaz, konkretisht në drejtimin e shkencave të natyrës, sepse mendoj se i përkas atij drejtimi. Kurse sa i përket profesionit të jetës sime ende nuk kam diçka konkrete. Shpresoj se këtë vendim do ta marr gjatë shkollimit tim të mesëm. Kisha nderin dhe kënaqësinë që isha nxënëse e kësaj shkolle. Dua t'i falënderoj të gjithë arsimtarët tanë, të cilët nuk kursyen asgjë nga vetja, që ne të jemi nxënës shembullor, si në mësim, ashtu edhe në sjellje.

ERËZA CURRAJ:



Secili profesion ka bukuritë e saj, pasiguritë dhe dinamikat, por gjëja më e rëndësishme është që të jetë me dashuri dhe përkushtim ajo që bëjmë.

E ardhmja nuk është vetëm një pjesë në jetën tonë. Atë duhet ta mendojmë gjatë gjithë kohës. Si gjithë të tjerët,

edhe unë kam një ëndërr, që në të ardhmen të bëhem një mjeke e suksesshme. T'i ndihmoj të sëmurët, kur ata kanë nevojë për mua.

E di, më duhet punë dhe përkushtim i madh për këtë drejtim, por unë kam besim në vetvete. Do të bëj çmos për ta realizuar këtë ëndërr, që gjithmonë e kam dashur.

FITORE SELIMAJ:



Është kjo njëra ndër pyetjet që i bëhet çdo nxënësi, kur është në vitin e fundit të shkollës së mesme të ulët, më saktësisht në klasën e nëntë. Unë në të ardhmen kam menduar të studioj pikturën, pra të bëhem një pikto e zonja. E dua këtë profesion, sepse më pëlqen gjithçka lidhur

me pikturën, ngjyrat apo më saktësisht gjithçka që ka të bëjë me artin. Andaj, shpresoj shumë që shkollën e mesme ta përfundoj me sukses dhe më pas edhe studimet e tjera dhe në fund të pajisem me diplomë, sepse të kesh një diplomë për profesionin që e do është ëndërra e çdo nxënësi. Por, gjithsesi, përkushtimi, besimi në vetvete është gjëja e vetme që të mundëson të arrish atë që ti dëshiron në jetë. Prandaj, jo vetëm në nxënësit, por edhe çdo person tjetër duhet të besojë te vetja, se një ditë, vërtet, do ta arrijë atë që gjithmonë e ka dëshiruar.

ERZA BEQIRAJ:



Çfarë pas gjithë këtyre viteve? Pas kësaj shoqërie të mrekullueshme, një jetë e re? Sigurisht që jo. Por, vazhdim i gjithë asaj që ndërtoam deri më sot. I jam falënderues arsimtarëve tanë, që dhanë çdo gjë nga vetja, që të jemi shembullorë në çdo aspekt.

Pas klasës së nëntë do të përcaktohem për profesionin, që, gjithsesi, do t'i kontribuoj shtetit dhe shoqërisë. Asnjë profesion tjetër, përveç atij të mjekësisë nuk mund të jetë kontribues. Të ardhmen time e shoh si një mjeke, në një institucion shëndetësor, duke iu shërbyer qytetarëve pa dallim gjinie, feje, etnie...

ANKETË ME NXËNËSIT E KLASAVE TË NËNTA

AURELA CURRAJ:

A ka më mirë se të frymsh me ata persona, që ta falën dijen. Më kujtohet hera e parë, kur u ula në këto banka shkollore. Pashë shumë fytyra të panjohura. Ato fytyra tashmë janë shokët dhe shoqet e mia, pa të cilët nuk e paramendoja jetën.

Pas mbarimit të klasës së nëntë do të regjistrohem në shkollën e mesme të mjekësisë. Është ky profesioni që unë më së miri mendoj se do të gjendem. Dua të bëhem person i sinqertë, i besueshëm. Do t'u ndihmoj njerëzve, si dhe t'u jap shpresë për të vazhduar më tutje.

ERMIRASELIMAJ:



Sa shpejt ikën jeta. Ajo hap krahët e saj të brishtë dhe merr fluturimin e largët, për të na dërguar në horizonte të panjohura për ne.

Mundi dhe sakrificat e mësimdhënësve është e pafund. I falënderohem të gjithë arsimtarëve, që më dhuruan dituri, e veçanërisht një falënderim për mësuesen time të parë, Besa Beqiraj, ku njohuritë e para i mora nga Ajo. Një respekt të veçantë kam edhe për kujdestarin tim, Nasuf Krasniqin.

Erdhi koha që të mendoj për të ardhmen time. Dalëngadalë edhe klasës së nëntë po i vjen fundi. Të ardhmen time e shoh në drejtimin e shkencave natyrore në Gjimnazin e Therandës. Pas përfundimit të gjimnazit, mendoj që t'i vazhdoj studimet universitare për mjekësi.

Koha nuk pret që ti të realizosh ëndrrat tuaja, prandaj duhet të vraposh drejt tyre sa më parë, sepse koha ikën e nuk kthehet më kurrë.

AGNESAZMALAJ:



E ardhmja është ajo, për të cilën duhet punuar shumë. Duhet shumë mund e po aq edhe përkushtim.

Kam bërë shumë përpjekje që të jem nxënëse e shkëlqyeshme. Këtë e desha shumë dhe e arrita. Gjithmonë jam munduar që me pak forcë të prek majat e suksesit. Tani është koha, kur jeta ime do të marr kahje tjetër. Është koha, ku duhet të vendos për të ardhmen time.

Deri më tani ende nuk kam vendosur për ndonjë profesion, mirëpo mendoj që shkollimin ta

vazhdoj në gjimnazin e shkencave shoqërore. Shpresoj se në fund të arrij atë që dëshiroj.

LEONITAHAXHAJ:



Vitet ecin e bashkë me to edhe ne. Çdo fillim ka edhe fundin e saj. Prandaj, edhe ne arritëm në përfundim të klasës së nëntë. Emocionet nuk kanë të ndalur. Po kaloj momente të bukura me ata persona që më shoqëruan plot nëntë vjet.

Të ardhmen time të afërt e shoh në shkollën e mesme të mjekësisë. Nuk njoh ndonjë profesion më të denjë për mua. Vetëm ta mendosh se sa bukur është kur vij në persona që ta besojnë veten e tyre ty për shërim. Do të jetë një rrugëtim i gjatë dhe me plot sakrificat, por besimi në vetvete, si dhe mbështetja e familjes dhe e shoqërisë do ta thyejnë këtë sakrificë.

ARGJIR QELAJ:



Përzgjedhja e një profesioni të caktuar është një prej vendimeve që ne duhet ta marrim në jetë, pavarësisht asaj sesa jemi të bindur te vetja se mund t'ia dalim. Prandaj, shpeshherë vihet në pyetje edhe aspekti socio-ekonomik. Në disa raste ekzistojnë edhe imponimet nga të tjerët, që na bëjnë disi që ta deformojmë mendimin tonë, në lidhje me atë se çfarë duam të studiojmë dhe të punojmë në të ardhmen.

Ndryshe nga të gjitha vendimet e tjera që marrim në jetë, duke filluar nga përzgjedhja e drejtimit të shkollës së mesme, me anë të të cilit ne hedhim hapat e parë, në lidhje me profesionin; pastaj përkushtimi ynë ndaj këtyre viteve e deri kur vijmë te përzgjedhja e profesionit tonë ndodh që nuk arrijmë dot të përcaktohem për ndonjë nga profesionet.

Unë në të ardhmen dëshiroj që të bëhem mjek. E dëshiroj shumë këtë profesion, ngase kam dëshirë që t'u ndihmoj të rriturve dhe fëmijëve. Profesionin e mjekut është njëri nga profesionet më humane, sepse shëron shumë jetë.

Shpresoj se në të ardhmen do t'ia arrij këtij qëllimi.

*Anketën e zhvilluan:
Besa BEQIRAJ & Zeli LUSHAJ*

FESTAT E NËNTORIT

Zemra më bëhet mal më shumë se kurrë. Është muaji i krenarisë shqiptare. Nëntori bashkë me flladin dhe ngricat sjell me vete edhe një mori kujtimesh e histori për gjakun e derdhur ndër shekuj. Për luftrat dhe rezistencën e popullit shqiptar. Në këtë muaj gjaku i derdhur u ngri në përjetësi dhe solli pavarësinë e Shqipërisë.

Thonë se njerëzit e mëdhenj lindin në ditët e mëdha. Pikërisht më 28 Nëntor ne festojmë edhe ditëlindjen e komandantit legjendar, Adem Jashari. Ai u bë udhërrëfyes i shumë brezave se si duhet luftuar e flijuar për liri. Ai i priu luftës së lavdishme të UÇK-së, e cila pikërisht në këtë datë doli fituese e dha shpresë e jetë popullit shqiptar. Trimat shqiptarë dhanë çdo gjë nga vetja për lirinë që po e gëzojmë sot. Dëshmorët e kombit dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Lavdi trimave dhe u qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

Erza BEQIRAJ, kl. IX/1

DËSHMORËT

Ka vetëm një rrugë, ku është shkruar historia e lirisë. Ajo rrugë është gjaku i dëshmorëve. Ata ishin të gatshëm që të plotësojnë amanetin dhe të japin jetën për atdhe e për liri.

Kaluan dhe do të kalojnë vite e shekuj, por asnjëherë nuk do t'i harrojmë dëshmorët tanë, të cilët dhanë më të shtrenjtën – jetën për lirinë që ne sot po e gëzojmë. Dëshmorët tanë janë nderi dhe krenaria e popullit shqiptar. Brez pas brezi do t'i kujtojmë me respekt e krenari. A e dini se cilat janë lulet më të bukura dhe me çfarë ujiten? Lulet më të bukura janë lulet e lirisë, që ujiten me gjakun e dëshmorëve.

Lavdi dëshmorëve të kombit tonë! Qoftë i përjetshëm kujtimi për TA!

Granit Kicaj, kl. VII/1

DITËT E SHKOLLËS

Sikur çdo ditë e jetës së përditshme, që bëjmë pa obligime siç është loja, shikimi i televizionit e aktivitete të ndryshme, të cilat na bëjnë të lumtur, pjesë e rëndësishme e jetës sonë janë edhe ditët që vijmë në shkollë. Prandaj, secilën ditë të shkollës duhet ta kalojmë sa më mirë, pa problem, pa grindje, pa mosmarrëveshje...

Arsyeja është se një ditë do të dëshironim, që t'i kujtojmë ditët e shkollës, siç mund t'i kujtojmë edhe pjesët e tjera të ditës, ngase në çdo moment mund të kalojmë çaste të bukura, por edhe pikëlluese.

Ditët e shkollës duhet të jenë pjesët më të veçanta se çdo moment tjetër që përjetojmë, sepse ndikojnë në çdo hap të jetës sonë.

Përjetojini dhe kujtojini ditët e shkollës në mënyrën sa më të bukur, sepse ato janë edhe pjesë e së ardhmes sonë!

Shkëndije Kicaj, kl. VIII/2

Art figurativ

ARTI ËSHTË PASURI E CIVILIZIMIT NJERËZOR DHE KREATIVITET SHPIRTËROR

Arti është proces apo produkt i rregullimit të elementeve simbolike kompozicionale figurative, për të tërhequr vëmendjen e shqisave apo emocioneve. Arti përfshinë një gamë të gjerë të aktiviteteve, krijimeve dhe mënyra të shprehjes njerëzore, përfshirë muzikën, filmin, vizatimin, skulpturën, grafikën, dizajnin dhe pikturën. Kuptimin dhe domethënien e artit e studion estetika.

Arti figurativ është prodhim i kreativitetit shpirtëror të njeriut prej parahistorisë e deri më sot. Veprat figurative janë dëshmitare për zhvillimin e mendimit dhe civilizimit njerëzor. Veprat për ne paraqesin pasuri shpirtërore të pakontestueshme.

Arti figurativ paraqitet me vepra, të cilat realizohen me materiale të llojllojshme në hapësirë dydimensionale dhe tredimensionale.

Historia e artit merret me studimin e artit figurativ prej parahistorisë e deri më sot.

Arti figurativ është pasuri e civilizimit të njerëzimit dhe kreativitetit shpirtëror.

Arti figurativ është art vizuel, veprat e te cilit i përceptojmë dhe i përjetojmë me anë të të parit dhe me anë të të prekurit.

Arti figurativ shprehet me anë të gjuhës së artit figurativ, d.m.th me anë të elementeve dhe parimeve figurative. Vija është mjeti kryesor, për shprehje figurative në vizatim me një ose me shumë ngjyra. Vizatohet në teknika të ndryshme dhe me materiale të llojllojshme, me të cilat mund të përpunohet vizatimi. Duke përdorur llojllojshmërinë e materialeve krijohet mundësia, që të fitohen lloje të ndryshme të vijave me bukuri specifike. Në mësimin nga arti figurativ vizatohet me laps, thëngjill, shkumësa të llojllojshme, pastel të thatë, pastel të yndyrshëm, tush, bajc, si dhe me ngjyra tempere dhe akuarel.

Si fushë më vete, arti figurativ në krijimin e veprave artistike me mënyra të ndryshme, si dhe me materiale të ndryshme paraqitet me harmonizimin, baraspeshën, hapësirën; me botën e brendshme shpirtërore, estetike, imagjinative, si dhe aspektin emocional, duke mos anashkaluar: trajtat, vijat, ngjyrat, raportin dritë-hije, si dhe kontrastin.

Nëse nuk i ka të gjitha këto të lartpërmendurat një veper artistike, atëherë nuk mund të themi se ka kreativitet apo është artistike.

Fahri KUKAJ, prof. i artit figurativ



KOPSHTI POETIK



NËNA

Është personi që në jetë na solli
Është ajo që çdo herë pranë na qëndroi
Nënë ti je ajo që kur qaja lotët m'i fshije
Ti je ajo që kur rrëzohesha prapë më ngrije.

Te ti nënë gjithmonë u mbështeta
Dhe me ty asnjëherë vetëm nuk mbeta
Prandaj nënë asnjëherë nuk dua
Të të shoh të mërziur
Sepse shumë mundime pate
Nënë për të na rritur.

Fitore Selimaj, kl. IX/1

KOSOVA DHE SKËNDERBEU

Sa shumë vite priti
Sa shumë ëndërroi
Kosova jonë e dashur
Lirinë ta gëzojë.

Me gjakun e dëshmorëve
U mbulua kjo tokë
Ngritën përmendore
Ndër vërrije e bokë.

Kosovën e bënë
Edhe më të gëzuar
Skënderbeu krenar
Në mes të saj duke qëndruar.

Dhe ajo
Që nga Jugu e në Veri
Na i mbush zemrat
Plot dashuri.

Djellza Tafaj, kl. IX/2



**Eurona Selimaj,
kl. VIII/2**

DËSHMORIT SAFET KICAJ

Pse këto lule më nuk çelin
A thua morën vesh se vdiq Safeti
Jo more jo gabim e kanë kuptuar
Se dëshmorët nuk vdesin kurrë
Ata janë duke jetuar.
Ishte shumë i ri kur mori pushkën
Për liri nuk iu dhimbs jeta
Ra dëshmor për këtë vend
Gjithmonë do të kujtohet me pietet.

Granit Kicaj, kl. VII/1

ASNJËHERË

Gjithçka që u doli përpara e dogjët
Në nuk u dorëzuam asnjëherë
E vratë çdo shqiptar të pafajshëm
Por ne nuk ikëm asnjëherë.

Na okupuat në çdo vend
Ne nuk u larguam asnjëherë
Ushtruat terror e gjenocid
Por nuk u frikësuam asnjëherë.
Futët tmerr te fëmijët
Por ata nuk ndjejnë më frikë
Ata sot mbrojnë prapun
Për çdo armik.

Leonita Kicaj

**Eurona Selimaj,
kl. VIII/2**



POEZI PËR HAXHIUN

Puthe djalin për të fundit herë
Nënë e baba ta dhanë bekimin
Dole bjeshkës në pranverë
Ëndrra jote ishte çlirimi.

Ishe trim me palcë kosove
Për liri jetën e fale
TI armikut përballë i dole
Për këtë shtet jetën e fale.

Mbete Haxhi Haxhaj
Në Semetisht si bajrak
Djalë i kombit nga Grekocit
Epopenë e shkrove me gjak.

Ti je biri i poezisë
Je në vargjet e një kënge
Luftëtar i lirisë
Trim i fjalës atdhetare.

Ti je Haxhi shqiptaria
Je midis nesh
Ti jeton tek ardhmëria
Agon dita e na buzëqesh.

Shirat e vjeshtës dhe pëshpërimat
Na sjellin pranë heroin tonë
Ato që shkrep si vetëtima
Tokën nënë e kishe të shenjtë.

Malli për TY na dogji jetën
I pyes zogjtë mos të kanë parë
Pyes erën që fryen Grekocit
Bjeshkët e Semetishtit thonë
që është gjallë.

Vanesa Haxhaj, kl. VIII/2

ESE

8 MARSI - DITA E NËNËS

Një ditë, që bart respekt, dashuri të pafund, për ato, që na dhanë jetë nga jeta e tyre. Për ato që natën e bënë ditë dhe na mekuan me qumësht nga gjiri i tyre. Për ato që gjenden pranë, sado larg që të jemi, sa herë zemrat tona dëshpërohen, sa herë shpirtrat tanë rënkojnë. Për atë krijesë të Zotit, mbushur me kaq dashuri, me kaq mirësi. Ndaj sot, në këtë ditë të shënuar po mbështes kokën dhe mendimet e mia, në prehërin e nënës sime, në prehërin e nënave tuaja, në atë prehër, ku loti thahet si me magji dhe brengat e trishtimet largohen. Aty ku ka diell, dritë, paqe, lumturi, qofshin gjithmonë nënat tona! Gëzuar festën e 8 Marsit për të gjitha nënat e botës, për ato më të dhembshurat, më të mirat, me të shtrenjtat.

Dera e urimeve është e hapur, se në shpirtin e një nëne nuk ka nevojë të trokasësh.

Rita CURRAJ, kl. VI/1





KOPSHTI POETIK



MARSI

Nëna ime e dashur
Çke hequr me mua
Tani do të të tregoj
Sa shumë që dua.

Buzëqeshja jote
Më shumë se diell
shndërrit
Fjalët e tua në rrugë
më prinë
Nënë e imja nënë.

Përqaftimi yt
Më jep ngrohtësi
Do të të dua nënë
Deri në pafundësi.

Hadi Kicaj, kl. III/2

NËNA IME

Nëna ime e dashur
Sa shumë që të dua
Ti gjithmonë ke pasur
Shumë durim me mua.

Pranë më qëndron
Kur jam i sëmurë
Natën më shikon
Mos kam temperaturë.

Ti për mua je
Thesar i çmuar
Gjithmonë do të jesh
Diell i pashuar.

Edison Lushaj

NËNA

Një puthje të ëmbël
Dhe shumë falënderime
Ty oj nëna ime
Të dërgoj nga zemra ime.
Të jam mirënjohës
Të falënderoj
Se çdo gjë në këtë jetë
Ty do të kushtoj.
Ti je yll i pashuar
Je si zanë e zbukuruar
Nënë moj e shtrenjta nënë.

Arnita Kicaj, kl. III/2



Fitore Selimaj

NËNA IME

Nëna ime e dashur
Sa fort të dua
Vjersha, tregime
e përralla
Nga ti i kam mësuar.

Qëndrove pa gjumë
Ditë dhe natë
Më këndoje ninulla
E më dërgoje në shtrat.

Më rrite deri në këtë
moshë
Tani po shkoj në shkollë
Me pesat që marr
TY të gëzoj.

Altin Beqiraj, kl. V/1

POEZI PËR DËSHMORËT

Kjo është e vërtetë
Nuk është përrallë
Dëshmorët e lirisë
Ende janë gjallë.

Dëshmorët mposhtën armikun
Me beteja legjendare
Për të hyrë ballëhapur
Në historinë kombëtare.

Ndaj, për ta duhet zgjedhur fjalët
Shkrimet, shprehjet e poezitë
Sepse siç i patën madhore veprat
Të veçanta i kishin dhe trimëritë.

Rinesa Kicaj, kl. VII/2

DO TË VIJË NJË DITË

Do të vijë një ditë
Ah, sikur të vijë një ditë
Kur do të kenë të varfërit
Ashtu sit ë pasurit.

Do të shikojnë të verbërit
Çdo gjë të vërtetë
Do të flasin memecët
Për çdo gjë në jetë.

Do të dëgjojnë të shurdhërit
Dhe të gëzojnë lumturinë
Do të ecin të çalët
Dhe të pushtojnë gjithësinë.

Do të ngjallen të vdekurit
Dhe dëshmorët që ranë për liri
Dhe të gëzojnë së bashku
Të bukurën Dardani.

Diellza Tafaj, kl. IX/2

ADEM JASHARI

Adem Jashari legjendar
Trim i madh kosovar
Bashkë me Hamzën duke luftuar
Kosovën për ta çliruar.

Kosova jonë tash je e lirë
E heronjtë i ke të mire
E dhanë gjakun për liri
Për të shtrenjtën pavarësi.

Tani do të jetë e lirë
E gjithë shqiptaria
Rroftë Kosova jonë
Rroftë e gjithë Shqipëria!

Rinesa Canaj, kl. IX/2

ADEM LEGJENDARIT

Luftëtar i paepur
Që dha jetën për liri
Populli s'e harron këtë vepër
S'e harron heroizmin e tij.

Si hero, hero i vërtetë
Si një trim, trim me fletë
Bëri vdekjen si me le
E dha gjakun për atdhe.

Elmedina Canaj, kl. VII/2

DËSHMORËT

Përballuat rrebeshet e armikut
Pa masë çmuat atdhedashurinë
Retë shpërdatë e qiellin ndriçuar
Derdhët gjakune sollët lirinë.

Përulemi para jush
Këngë për JU këndojmë
Fitoret që dhuruat
do t'i ruajmë si sytë
Në shenjë respekti lule
JU dhurojmë çdo ditë.

Aurela Brahaj, kl. IX/1
KOSOVA IME

S'ka thesar në botë
Që vlen sa liria
Atdheu mbi të gjitha
E jona pavarësia.

Sa nëna derdhën lotë
Sa trima ranë për këtë tokë
Që të shohin Kosovë si sot
Të bashkuar të gjithë tokë.

Sot jemi të lirë
E gëzojmë pavarësinë
Por janë trimat e Kosovës
Që meritojnë lavdinë.

Naile Kurtishaj, kl. IX/1

MËSUESJA IME

Mësuesja ime
TY të qofsha falë
Ma ndrite jetën time
që në klasë të parë.

Çdo ditë mbi tavolinë
unë librin e lexoj
Me mall tre muaj
pushim
TY të kujtoj

Ah, mezi pres
shtatorin t'ia nisim si
në fillim
T'i dëgjoj fjalët e tua
që më mbesin në
shpirtin tim.

*Kosovare Selimaj,
kl. V/2*

NËNA IME

Sa herë zgjohem në mëngjes
Nënë time e përhëndes
Mirëmëngjesi e dashura nënë
Të kam shpirt e të kam xhan.

Unë nënën time shumë e dua
Se më rriti me shumë mund mua
Nënë gjithmonë në zemër të kam
Unë me TY krenar jam.

Ledion Kurtishaj, kl. III/1

PRANVERA

Erdhi pranvera në
vendin tonë
Kjo stinë e bukur
me plot aromë
Çelin lulet e pemët
si përherë
Në këtë stinë të bukur
– në pranverë.
E gjithë natyra shkëlqen
ngjyra-ngjyra

Secila nga lulet
Është më e mira
Këndojnë bilbilat
me zë

Gjithnjë pa pushim
Gu, gu, gu bëjnë
shpendët
Në vendin tim.
Lulet e pranverës,
natyrën e lulëzojnë
Me bukurinë e saj
të ëmbël
Qiellin e pushtojnë
Herët në mëngjes
Trokiti dhe u hap dera
Gëzohuni, gëzohuni
Se na erdhi pranvera.

Rina Beqiraj, kl. V/1

Dëshmorët e Grekocit

FESTAT E NËNTORIT

Zemra më bëhet mal më shumë se kurrë. Është muaji i krenarisë shqiptare. Nëntori bashkë me flladin dhe ngricat sjell me vete edhe një mori kujtimesh e histori për gjakun e derdhur ndër shekuj. Për luftrat dhe rezistencën e popullit shqiptar. Në këtë muaj gjaku i derdhur u ngri në përjetësi dhe solli pavarësinë e Shqipërisë.

Thonë se njerëzit e mëdhenj lindin në ditët e mëdha. Pikërisht më 28 Nëntor ne festojmë edhe ditëlindjen e komandantit legjendar, Adem Jashari. Ai u bë udhërrëfyes i shumë brezave se si duhet luftuar e flijuar për liri. Ai i priu luftës së lavdishme të UÇK-së, e cila pikërisht në këtë datë doli fituese e dha shpresë e jetë popullit shqiptar. Trimat shqiptarë dhanë çdo gjë nga vetja për lirinë që po e gëzojmë sot. Dëshmorët e kombit dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Lavdi trimave dhe u qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

Erza BEQIRAJ, kl. IX/1

DËSHMORËT

Ka vetëm një rrugë, ku është shkruar historia e lirisë. Ajo rrugë është gjaku i dëshmorëve. Ata ishin të gatshëm që të plotësojnë amanetin dhe të japin jetën për atdhe e për liri.

Kaluan dhe do të kalojnë vite e shekuj, por asnjëherë nuk do t'i harrojmë dëshmorët tanë, të cilët dhanë më të shtrenjtën – jetën për lirinë që ne sot po e gëzojmë. Dëshmorët tanë janë nderi dhe krenaria e popullit shqiptar. Brez pas brezi do t'i kujtojmë me respekt e krenari. A e dini se cilat janë lulet më të bukura dhe me çfarë ujiten? Lulet më të bukura janë lulet e lirisë, që ujiten me gjakun e dëshmorëve.

Lavdi dëshmorëve të kombit tonë! Qoftë i përjetshëm kujtimi për TA!

Granit Kicaj, kl. VII/1

DITËT E SHKOLLËS

Sikur çdo ditë e jetës së përditshme, që bëjmë pa obligime siç është loja, shikimi i televizionit e aktivitete të ndryshme, të cilat na bëjnë të lumtur, pjesë e rëndësishme e jetës sonë janë edhe ditët që vijmë në shkollë. Prandaj, secilën ditë të shkollës duhet ta kalojmë sa më mirë, pa problem, pa grindje, pa mosmarrëveshje...

Arsyeja është se një ditë do të dëshironim, që t'i kujtojmë ditët e shkollës, siç mund t'i kujtojmë edhe pjesët e tjera të ditës, ngase në çdo moment mund të kalojmë çaste të bukura, por edhe pikëlluese.

Ditët e shkollës duhet të jenë pjesët më të veçanta se çdo moment tjetër që përjetojmë, sepse ndikojnë në çdo hap të jetës sonë.

Përjetojini dhe kujtojini ditët e shkollës në mënyrën sa më të bukur, sepse ato janë edhe pjesë e së ardhmes sonë!

Shkëndije Kicaj, kl. VIII/2

Art figurativ

ARTI ËSHTË PASURI E CIVILIZIMIT NJERËZOR DHE KREATIVITET SHPIRTËROR

Arti është proces apo produkt i rregullimit të elementeve simbolike kompozicionale figurative, për të tërhequr vëmendjen e shqisave apo emocioneve. Arti përfshinë një gamë të gjerë të aktiviteteve, krijimeve dhe mënyra të shprehjes njerëzore, përfshirë muzikën, filmin, vizatimin, skulpturën, grafikën, dizajnin dhe pikturën. Kuptimin dhe domethënien e artit e studion estetika.

Arti figurativ është prodhim i kreativitetit shpirtëror të njeriut prej parahistorisë e deri më sot. Veprat figurative janë dëshmitare për zhvillimin e mendimit dhe civilizimit njerëzor. Veprat për ne paraqesin pasuri shpirtërore të pakontestueshme.

Arti figurativ paraqitet me vepra, të cilat realizohen me materiale të llojllojshme në hapësirë dydimensionale dhe tredimensionale.

Historia e artit merret me studimin e artit figurativ prej parahistorisë e deri më sot.

Arti figurativ është pasuri e civilizimit të njerëzimit dhe kreativitetit shpirtëror.

Arti figurativ është art vizuel, veprat e te cilit i përceptojmë dhe i përjetojmë me anë të të parit dhe me anë të të prekurit.

Arti figurativ shprehet me anë të gjuhës së artit figurativ, d.m.th me anë të elementeve dhe parimeve figurative. Vija është mjeti kryesor, për shprehje figurative në vizatim me një ose me shumë ngjyra. Vizatohet në teknika të ndryshme dhe me materiale të llojllojshme, me të cilat mund të përpunohet vizatimi. Duke përdorur llojllojshmërinë e materialeve krijohet mundësia, që të fitohen lloje të ndryshme të vijave me bukuri specifike. Në mësimin nga arti figurativ vizatohet me laps, thëngjill, shkumësa të llojllojshme, pastel të thatë, pastel të yndyrshëm, tush, bajc, si dhe me ngjyra tempere dhe akuarel.

Si fushë më vete, arti figurativ në krijimin e veprave artistike me mënyra të ndryshme, si dhe me materiale të ndryshme paraqitet me harmonizimin, baraspeshën, hapësirën; me botën e brendshme shpirtërore, estetike, imagjinative, si dhe aspektin emocional, duke mos anashkaluar: trajtat, vijat, ngjyrat, raportin dritë-hije, si dhe kontrastin.

Nëse nuk i ka të gjitha këto të lartpërmendurat një veper artistike, atëherë nuk mund të themi se ka kreativitet apo është artistike.

Fahri KUKAJ, prof. i artit figurativ



KOPSHTI POETIK



DËSHMORIT TË RËNË PËR LIRI

Mos më thuani se vdiq
Mos më thuani se nuk është më
I miri e i bukur i nënës
Është në zemër tashmë.

Mos më thuani ku e qëlluan
plumbat

Nëna e di, në krahavor
Çelën bozhuret e gjakut
Si lulëkuqet në dëborë.

Mos më thuani se s'vjen më
Do ta pres te pragu i derës
E ai do të vijë si gjithnjë
Sikur filladi i pranverës.

Do të vijë si agimi i ditës
Zemra e nënës do të vijë
I ndritshëm si rrezja e diellit
Magjeps si hyjni.

Mos më thuani se jam e vetme
Se kam mbetur fillikat
Ai do të vijë me shokë netëve
Pushkën do ta varë mbi shtrat.

Mos më thuani se vdiq im bir
Ai ka rënë, por nuk ka vdekur
Në udhën e lirisë për ku ishte nisur
Duhej derdh gjak për të arritur.

Secili prej tyre kishte mall për atdhe
Por mbi të gjitha një dëshirë
Ta zhdukim errësirën e rëndë
Që Kosova të jetojë e pavarur dhe e lirë.

Mos më thuani, asgjë mos më thuani
Ai do të vijë me fitore ndaj armikut
Fshijeni lotin dhe shikoni lart
Ai është në malet e Pashtrikut.

Elionisa Lushaj, kl. VII/2

NËNA E MËSUESJA

Si dy lule
Që çelin në pranverë
Janë nëna dhe mësuesja
Që i dua përherë.

Nëna ime shndërrit
Mësuesja ime rrezatim
E para me dashuri më rrit
E dyta më mëson.

Që të dyja
Unë i çmoj
I dua me zemër
Dhe i respektoj.

Rrezona Selimaj, kl. VI/2

Nr. 12 - prill, 2017

8 MARS

O mami im
O yll e dritë
Dhurata e lule
Dua të të fal çdo ditë.

Merre këtë lule
Të paqë përherë në jetë
Më përqafo fort
Nga jeta jote më jep jetë.

Erbilin Beqiraj, kl. V/2

LIBRI

Libri im i dashur
Sa shumë të dua
Nga ti mësova
Shumë gjëra të çmuara.

Ti diturinë
Më dhurove mua
Çdo ditë të shfletoj
Diçka të re mësoj.

Enkela Qelaj, kl. IV/2

8 MARS

Sot është festa jote
Në zemër ke gëzime
Shumë urime për TY
E shtrenjta, nëna ime.

E dashura nënë
Ti je e çmuar për mua
Në thellësinë e zemrës
Unë vetëm ty të dua.

Elona Beqiraj, kl. IV/2

8 MARS

Vjen 8 Marsi për çdo vit
Festa e nënës na sjell dritë
Gjithmonë kujtohem si t'ia uroj
Çka është më së miri nënën ta gëzoj.

Nëna është si yll që ndriçon
Si dritë në zemër e kam gjithmonë
Na këshillon për mësim e sjellje të mire
Për mua thotë është dhurata më e mirë.

Nëna ime shumë të dua
Fjala jote më jep jetë
Dora jote më ledhaton
Të gjitha dhembjet t'i shëron.

Rinor Selimaj, kl. V/2

KOSOVË TOKË E PËRGJAKUR

Kosovë, tokë e përgjakur
Mali sa shumë na mori për TY
Armikun shekullor e flake
Për të parë përsëri me sy.

Na ndoqi armiku nga vatrat
Të gjithëve një nga një
Na i dogji qytetet dhe fshatrat
Dhe na dëboi në Shqipëri.

Të gjithë ishin të pikëlluar
Që lame të dashurën Kosovë
Mbijetuam duke shpresuar
Se do të kthehemi në tokën tonë.

Armikun, përbindëshin e krisur
Që na trazoi fëmijërinë
Tërë bota e ka braktisur
Se na prishi lumturinë.
Mos qaj Kosovë
Na bekoj nëna Shqipëri
Gjaku që është derdhur
U shndërrua në LIRI.

Behar Tafaj, kl. VI/2

MËSUESIT TIM

Pesë vite ecjeje shtigjeve
të diturisë
Me dashuri në zemrën time
Virtytet e një prindi
madhështor
Shkëlqente në klasën time.

Se ti më fale dashurinë
Arrite me dituri pa fund
Mua të më edukosh
I dashur mësuesi im.

Një vit ka kaluar
Por s'rri dot pa të kujtuar
Kur të shoh me ditar
Më duket vetja si në klasë
të parë.

Kur hynte në klasë
Ai më vinte pranë
Më bëhej zemra mal
Si ta kisha tërë dynjanë.

Sara Kicaj, kl. VI/2

VËLLAI IM

Kur vij nga shkolla
Vëllai im më përqafo
Unë ndihem i lumtur
Ai që më gëzon.

Kur qeshë vëllai im
Qielli bëhet kaltërsi
Se vëllai im i vogël
Mua më sjell mbarësi.

Kur të rritemi ne të dy
Do të bëhemi shkrimtarë
Që prindërit tanë
Të ndihen krenarë.

Redon Selimaj, kl. IV/1

PRANVERA

Kur vjen pranvera
Kemi shumë gëzim
Me lule mbushet
i gjithë vendi im.

Fëmijët dalin
Lozin e këndojnë
Dalin me nxitim
Pranverën ta shijojnë.
Shihni, shihni erdh pranvera!
Vjen bilbili si herave të tjera
Bari gjelbërohet, zogjtë cicërojnë
Ne pranverën po e festojmë.

Rina Demaj, kl. VI/2

MUNGESA E KOMPJUTERËVE PËR LËNDËN E INFORAMATIKËS NËPËR SHKOLLAT TONA

Viti i ri shkollor e gjen shkollën tonë SHMU“ Dëshmorët e Grekocit” në kushte të vështira infrastrukturore. Ajo që vërehet në përgjithësi është mungesa e bashkëpunimit mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore për përmirësimin e gjendjes, por pavarësisht kësaj, edhe pse jemi në vitin 2017, në shkollat shqiptare vështirë të gjesh laboratorë të informatikës të një niveli të kënaqshëm. Nxënësit edhe sot vijojnë të mësojnë mësimet nëpërmjet kompjuterëve në shtëpi apo ata nxënës, të cilët nuk kanë kompjuterë detyrohen që ta mësojnë me anë të librit dhe kjo është pothuajse e pamundur. Në të shumtën e rasteve ata shkojnë te një shok që ka kompjuter. Si pasojë nxënësit nuk mund të kryejnë siç duhet këtë orë mësimore. Po ashtu, pavarësisht



sloganeve të Kosovës në moshën e internetit, në vendin tonë vijon të ketë problem bazik me laboratorët e informatikës shkollore, që mungojnë në të shumtën e rasteve. Në rastin tonë ne i kemi vetëm gjashtë kompjuterë e që janë siguruar nga “Shoqata e Grekocit” me seli në Zvicër, me ç'rast i falënderoj shumë për këtë përkrahje që po i japin shkollës sonë.

Viti i fundit shkollor 2016-2017 nuk i plotësoi standardet e duhura, për t'u dhënë nxënësve shkollim cilësor. Sipas raportit të fundit të publikuar nga PISA vihet re mungesa e ambienteve mësimore dhe problemet në infrastrukturën e shkollave.

Në konkluzionet e raportit janë vënë në dukje mospajisja e shkollave me klasa laboratorë, për lëndët shkencore, mungesa e ambienteve për edukimin fizik e deri te mungesa e bibliotekave apo librave, që u vijnë në ndihmë nxënësve për të studiuar. Edhe pse për këtë, pushteti lokal ka investuar jo pak, por që aktualisht midis shkollave dhe bashkësive apo komunave nuk ka një bashkëpunim në nivelin e duhur. Në raport thuhet se në mjaft shkolla të vendit, prindërit

detyrohen të kontribuojnë me fonde për t'ju ardhur në ndihmë shkollave.

FACEBOOK PUSHTON NXËNËSIT

Facebook është bërë i pandalshëm edhe aty ku nuk lejohet. Mësuesit ankohen.

Rrjetet sociale janë bërë pjesë e jetës së përditshme për 60% të shqiptarëve. Statistikat flasin për një përdorim të gjerë, kryesisht të Facebook, por edhe Twitter, My space, Blogger, Netlog etj.

Përdoruesit janë të moshave të ndryshme, duke filluar që nga adoleshentet e deri te personat mbi 50 -vjeç.

Por, a përben problem përdorimi i këtyre rrjeteve?

A duhet të shqetësohen prindërit për fëmijët e tyre?

Më poshtë, po ju japim disa fakte për efektet që kanë rrjetet sociale për shëndetin tuaj.

Hidhni një sy para se të bëni “poke”, “like” apo “friend request”. Kurse në shkollën tonë, gjithashtu, nuk mungon përdorim i rrjeteve sociale, madje është i mbipërdorur brenda dhe jashtë territoreve të shkollës. Në shkollë nuk mungojnë selfiet dhe më pas upload në fb, chat me telefonin poshtë bankës apo pëlqimet e të



rejave të fundit, ku rreth 40% e nxënësve priren që të rrinë në facebook, në vend, që të dëgjojnë me vëmendje orën e mësimi.

Në shkollën tonë, mësuesit, janë relativisht të shqetësuar për shkak të mospërkushtimit të vëmendjes së mësimi. Për këtë arsye janë ndërmarrë masa për moslejimin e telefonave në shkollë, por s'ka pasur efekt dhe nuk ka funksionuar. Për këtë arsye prindërit e fëmijëve janë vënë në dijeni për këtë problem, që duhet të minimizohet sa më shumë.

*Hashim KUKAJ,
arsimtar i Informatikës*

FJALËKRYQI KLASIK

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22
1															■							
2							■															
3								■	■		■	■						■		■	■	
4			■	■													■					
5		■			■									■	■							
6								■	■								■		■			
7											■	■						■	■			■
8		■				■	■				■							■		■		
9	■	■		■	■													■			■	
10								■	■													
11														■	■	■			■			
12		■	■				■						■		■	■						
13				■				■		■		■								■		
14								■														

HORIZONTALISHT:

1. Themelues i Amerikës – një kontinet; 2. Punim toke – fekondim – aprovim; 3. Vend në Shqipëri – rrezja e madhe – emri i Baliqit – syprina – elektron; 4. Autoriteti qeveritar – jobarazim – futbollist i huaj; 5. Gjermania (simboli) – kampion – e bukura – kotem; 6. Që merret me art – kryeqendër shqiptare – bashkëtingëllore e 18-të – figura (shkurt); 7. Kantier – komandanti i UÇK-së (nofka) – përemër vektor (huaj) – një zanore; 8. Një zanore – SIO – Tokë pune – emër femre – bashkëtingëllore – antiretroviral; 9. Nistorja e autorit të fjalëkryqit – një e shtata pjesë e tokës – Asociacion traduccion adaptacion audiovizual de Espana; 10. Organ drejtues – punime me vlerë ... – Muhamet Sejdiu; 11. Vështrim prapa – bashkëtingëllore e 18-të – Mbyll (huaj); 12. Intenstiteti – Jo (huaj) – moti – identiteti (shkurt) – VSADU – Jo çift – emër (huaj) – zanore – zanore – emër mashkulli (rasa rrjedhore) – autoriteti qeveritar; 14. Banor i kontinentit të zi – terreni.

VERTIKALISHT:

1. Veshje burrash – dukuri natyrore; 2. Emër mashkulli – republika demokratike – notë muzikore – EF; 3. Radio akustik ranging – verifikimi i forcës – KR; 4. XHTI – shteti ku po zhvillohen luftime – JR – intensitet; 5. I vogli i lopës – 100 (huaj) – lloj pije; 6. Testamenti – shteti ynë; 7. Shkronjë dyshe – emër mashkulli – reduktim potencial i oksidimit – ai (huaj); 8. Përemër pronor – KT – Artan (shkurt) – EK; 9. Ndërmarrja bujqësore (shkurt) – UE – mjeshtri – shënim (huaj); 10. Dominique Joseph ... – televizioni italian – Përemër vektor – zanore; 11. Targa e Tiranës – Network ... – emri i poetit të shquar (rasa kallëzore); 12. Aks (huaj) – shkoi – SERVA – Faradi; 13. Emër (huaj) – lloj sporti – notë muzikore; 14. Rezistues – erdhi – shkurtesa e Universitetit Islamik në Gaza; 15. Notë muzikore – new music in Sweden – lloj dru; 16. Që lidhet me kushtetutën – metal i çmuar; 17. Minimumi (shkurt) – R – I – Përemër pronor – trajtë e shkurtër; 18. Ky (huaj) – bakër – Forcat e Armatosura të Kosovës – barcoletë; 19. Emër mashkulli – materiale të shkruara ose të shtypura për studimin e diçkaje; 20. Përemër vektor (huaj) – emri i djalit të Ali pashës – notë muzikore – një zanore; 21. Ke (pop.) – babai – emri i një letrari për fëmijë; 22. Zbuluesi i Amerikës.

E përpiloi: Tahir ZENELAJ

GALERIA E REVISTËS

KËNDI PARASHKOLLOREVE



Ardita Kicaj , kl. VII/1



Laura Tafaj, kl. VIII/2



Fitore Selimaj, kl. IX/1



VALLE E PARASHKOLLOREVE PËR NDER TË 17 SHKURTIT – DITËS SË PAVARËSISË



**BOTIMIN E KËTIJ NUMRI E SPONSORIZOI SHOQATA "GREIKOCI"
ME SELI NË OSSINGEN - ZVICËR**